



Prishtinë: 23.03.2023
Kodi i ZRRE-së: V_1683_2023

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Dëshmitë e paraqitura nga palët; dhe
- Rekomandimin e DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_R_2407_02_23**.

në seancën e mbajtur më datë 23.03.2023 nxori këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** ankesa e aplikuesit **T.K "TEA" N.T.SH** nga Komuna e Prizrenit, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi
- II. Mbetet ne fuqi Pëlqimi Elektroenergjetik i lëshuar nga KEDS me nr.10143 dt. 04.10.2022

A r s y e t i m

Aplikuesi me datë 24.11.2022 ka paraqitur ankesë pranë DMK-së në ZRrE duke kontestuar përgjigjen e KEDS-it nr. 12008 datë 17.11.2022, me të cilën është refuzuar kërkesa e tij për ndryshim të kushteve teknike të dhëna me PEE nr.10143 dt. 04.10.2022 dhe kanë mbetur në fuqi kushtet teknike të dhëna përmes Pëlqimit Elektroenergjetik nr.10143 dt. 04.10.2022.

- Investitori **T.K "TEA" N.T.SH** ka aplikuar për pëlqim elektroenergjetik në KEDS për objektin afarist-Banesor si dhe ka dorëzuar projektin elektrik. Sipas përmbledhjes së projektit vërtetohet se kërkesa është bere për këto njësi: Lamela A- 55 njësi banesore, 2 lokale dhe 1 njësi për shpenzime të përbashkëta(58 njësi; Pmnj=290 kW); Lamela B- 63 njësi banesore, 2 njësi lokale afariste dhe 1 njësi për shpenzime të përbashkëta(66 njësi; Pmnj=330 kW); Pompë e derivateve (1 njësi; Pmnj=25 kW); Restorant 1(1 njësi; Pmnj=35 kW); Restorant 2(1 njësi; Pmnj=35 kW). Sipas projektit shihet se investitori në kërkesën e tij ka paraqitur kërkesë për 127 njësi me fuqi Pmnj=715 kW. Fuqia e transformatorit Sint=1000 kVA ku fuqi maksimale të njëkohshme prej Pmnj=715 kW(sipas projektit elektrik)
Provë: Pëlqimi Elektroenergjetik nr. 3917 datë 29.04.2021
- Investitori **T.K "TEA" N.T.SH**, ka parashtruar kërkesë në KEDS që të i behet revidimi i Pëlqimit elektroenergjetik Nr.3917 datë 29.04.2021. Me datë 14.12.2021 KEDS ka lëshuar PEE nr. 12641 të reviduar ku ka theksuar se: Investitori fillimisht është pajisur me PEE nr.3917 datë 29.04.2021 për ndërtimin e trafo stacionit të tij privat Sn=1000 kVA. Në pamundësi të realizimit të punimeve sipas PEE paraprake investitori kërkon revidim të PEE. Pas shqyrtimit të kërkesës së investitorit, KEDS lëshon këtë Pëlqim elektroenergjetik të ri me kushtet teknike të caktuara më poshtë. Po ashtu në PEE është evidentuar vërejtja se: **Pompa e derivateve, Restoranti1 dhe Restoranti 2 nuk përfshihen në këtë PEE përderisa nuk kemi Pëlqim parimor nga ana e KOSTT për ndërtimin**



e objekteve nen linjën ekzistuese 110 kV. Bazuar ne te dhënat e Pëlqimit vërtetohet se zgjidhja teknike i është lëshuar për veprimtarin afariste dhe Banesore:

Lamela A-55 njësi banesore, 2 lokale dhe 1 njësi për shpenzime të përbashkëta (58 njësi; Pmnj=290 kW);

Lamela B- 63 njësi banesore, 2 njësi lokale afariste dhe 1 njësi për shpenzime të përbashkëta (66 njësi; Pmnj=330 kW);

Pompë e derivateve (1 njësi; Pmnj=25 kW) nuk përfshihet në këtë PEE;

Restorant 1(1 njësi; Pmnj=35 kW) nuk përfshihet ne kete PEE;

Restorant 2(1 njësi; Pmnj=35 kW) nuk përfshihet ne kete PEE.

PEE përfshin në total 126 njësi me fuqi Pmnj=620 kW.

Fuqia e transformatorit Sint=1000 kVA ku fuqi maksimale te njëkohshme prej Pmnj=620 kW (sipas projektit elektrik)

Provë: Pëlqimi elektroenergjetik i reviduar nr. 12641 datë 14.12.2021

- Investitori **T.K "TEA" N.T.SH**, ka parashtruar kërkesë në KEDS që të i bëhet revidimi i Pëlqimit Elektroenergjetik nr.12641 datë 14.12.2021. Me datë 23.08.2022 KEDS ka lëshuar PEE nr.8623 të reviduar ku ka theksuar se: Investitori fillimisht është pajisur me PEE nr.3917 datë 29.04.2021 për ndërtimin e trafo stacionit të tij privat Sn=1000 kVA. Në pamundësi të realizimit të punimeve sipas PEE paraprake investitori ka kërkuar revidim për ndryshimin e kushteve teknike dhe është pajisur me Pëlqim Elektroenergjetik Nr.12641 datë 14.12.2021. Përsëri ne pamundësi të realizimit të punimeve sipas PEE paraprake investitori ka kërkuar revidim të Pëlqimit Elektroenergjetik Nr.12641 datë 14.12.2021. Pas shqyrtimit të kërkesës së investitorit, KEDS lëshon këtë Pëlqim Elektroenergjetik të ri me kushtet teknike të caktuara me poshtë.
Po ashtu në PEE është evidentuar vërejtja se: **Pompa e derivateve, Restoranti1 dhe Restoranti 2 nuk përfshihen ne këtë PEE përderisa nuk kemi Pëlqim parimor nga ana e KOSTT për ndërtimin e objekteve nen linjën ekzistuese 110 kV.**

Bazuar në të dhënat e Pëlqimit vërtetohet se zgjidhja teknike i është lëshuar për veprimtarin afariste dhe Banesore:

Lamela A- 55 njësi banesore, 2 lokale dhe 1 njësi për shpenzime të përbashkëta (58 njësi; Pmnj=290 kW);

Lamela B- 63 njësi banesore, 2 njësi lokale afariste dhe 1 njësi per shpenzime te përbashkëta(66 njësi; Pmnj=330 kW);

Lagje me shtëpi banimi (38 njësi; Pmnj=190 kW);

Pompë e derivateve (1 njësi; Pmnj=25 kW) nuk përfshihet në këtë PEE;

Restorant 1 (1 njësi; Pmnj=35 kW) nuk përfshihet në këtë PEE;

Restorant 2 (1 njësi; Pmnj=35 kW) nuk përfshihet në këtë PEE.

PEE përfshin në total 162 njësi me fuqi Pmnj=810 kW.

Fuqia e transformatorit Sint=1000 kVA ku fuqi maksimale të njëkohshme prej Pmnj=810 kW (sipas projektit elektrik)

Provë: Pëlqimi Elektroenergjetik i reviduar nr.8623 datë 23.08.2022

- Investitori **T.K "TEA" N.T.SH**, ka parashtruar kërkesë në KEDS që të i bëhet revidimi i Pëlqimit Elektroenergjetik nr. 8623 datë 23.08.2022. Me datë 04.10.2022 KEDS ka lëshuar PEE nr.10143 të reviduar ku ka theksuar se: Investitori fillimisht është pajisur me PEE nr.3917 datë 29.04.2021 për ndërtimin e trafo stacionit të tij privat Sn=1000 kVA. Investitori nuk e ka marrë Pëlqimin Elektroenergjetik dhe ka kërkuar revidim për ndryshimin e kushteve teknike, ku edhe i është përgatitur Pëlqimi Elektroenergjetik Nr.12641 datë 14.12.2021 dhe me pas edhe Pëlqimi Elektroenergjetik Nr.8623 datë 23.08.2022. Investitori nuk e ka marrë Pëlqimin Elektroenergjetik dhe ka kërkuar revidim të Pëlqimi Elektroenergjetik Nr.8623 datë 23.08.2022. Pas shqyrtimit të



kërkesës së investitorit, KEDS lëshon këtë Pëlqim Elektroenergjetik të ri me kushtet teknike të cekura me poshtë.

Po ashtu në PEE është evidentuar vërejtja se: ***Pompa e derivateve, Restoranti1 dhe Restoranti 2 nuk përfshihen në këtë PEE përderisa nuk kemi Pëlqim parimor nga ana e KOSTT për ndërtimin e objekteve nen linjën ekzistuese 110 kV.***

Bazuar ne te dhënat e Pëlqimit vërtetohet se zgjidhja teknike i është lëshuar për veprimtarin afariste dhe Banesore :

Lamela A- 55 njësi banesore, 2 lokale dhe 1 njësi për shpenzime të përbashkëta (58 njësi; Pmnj=290 kW);

Lamela B- 63 njësi banesore, 2 njësi lokale afariste dhe 1 njësi për shpenzime të përbashkëta (66 njësi; Pmnj=330 kW);

Lagje me shtëpi banimi (38 njësi; Pmnj=190 kW);

Pompë e derivateve (1 njësi; Pmnj=25 kW) nuk përfshihet në këtë PEE;

Restorant 1 (1 njësi; Pmnj=35 kW) nuk përfshihet ne këtë PEE;

Restorant 2 (1 njësi; Pmnj=35 kW) nuk përfshihet ne këtë PEE.

PEE përfshin në total 162 njësi me fuqi Pmnj=810 kW.

Fuqia e transformatorit Sint=1000 kVA ku fuqi maksimale te njëkohshme prej Pmnj=810 kW(sipas projektit elektrik)

Provë: Pëlqimi Elektroenergjetik i reviduar nr. 10143 datë 04.10.2022

- Aplikuesi **T.K “TEA” N.T.SH**, ka parashtruar kërkesë ne KEDS qe te i behet revidimi i Pëlqimit Elektroenergjetik nr. 10143 datë 04.10.2022 duke kërkuar qe ti bëhen ndryshimet e kushteve teknike te kyçje s te dhëna përmes Pëlqimit Elektroenergjetik nr.10143 datë 04.10.2022.

Provë: Ankesa e aplikuesit në KEDS

- Me datë 06.10.2022 KEDS përmes një përgjigje e refuzon kërkesën e palës për ndryshim të kushteve teknike të dhëna me PEE nr.10143 dt. 04.10.2022, konkretisht mënyrën e kyçje s se trafo stacionit tuaj është refuzuar dhe mbesin në fuqi kushtet teknike të dhëna në Pëlqimin Elektroenergjetik nr.10143 datë 04.10.2022. Në arsyetimin e përgjigjes është theksuar se ju mund te vazhdoni me procedurën e realizimit te Pëlqimit Elektroenergjetik nr. 10143 datë 04.10.2022 për kyçjen e trafo stacionit te ri sipas zgjidhjes teknike të dhënë me PEE, sepse realizimi i linjës 10(20) kV në prona private nuk është i lejueshëm nga ana e KEDS-it. Po ashtu pas kërkesës së përsëritur të aplikuesit, për revidim të kushteve teknike të dhëna me PEE nr.10143 dt. 04.10.2022 duke ofruar edhe dokumente shtesë pronësore, me datë 17.11.2022 KEDS përmes një përgjigje e refuzon kërkesën e palës revidimin e PEE nr.10143 dt. 04.10.2022, dhe mbeten ne fuqi kushtet teknike të dhëna me PEE nr.10143 dt. 04.10.2022. Në arsyetimin e dhënë theksohet se: Propozimi i juaj nuk mund të realizohet për shkak se rruga ku ju keni kërkuar të ndërtoni linjën e re 10(20) kV nuk është rrugë publike. Linje a re 10(20) kV duhet të realizohet skaj rrugës publike. Për furnizim me energji elektrike të objekteve tuaja duhet bere ndryshimet e cekura ne PEE paraprak. Prandaj ju mund te vazhdoni me procedurën e realizimit te Pëlqimit Elektroenergjetik nr. 10143 datë 04.10.2022 sepse KEDS nuk e sheh te arsyeshme ndryshimin e kushteve teknike.

Provë: Përgjigjet e KEDS nr.10217 datë 06.10.2022 dhe nr.12008 datë 17.11.2022

- Me datë 21.11.2022 i pakënaqur me përgjigjen e KEDS-it, aplikuesi brenda afatit ligjor paraqet ankesë pranë DMK-së në ZRRE, duke kontestuar refuzimin e kërkesës së tij nga ana e KEDS-it.

Provë: Ankesa e datës 21.11.2022

Bordi i ZRRE-së duke analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e aplikuesit dhe KEDS, ka vërejtur se:



Investitori **T.K "TEA" N.T.SH** ka aplikuar për pëlqim Elektroenergjetik në KEDS për objektin afarist-Banesor, si dhe ka dorëzuar projektin elektrik. Sipas përmbledhjes së projektit vërtetohet se kërkesa është bërë për këto njësi: Lamela A- 55 njësi banesore, 2 lokale dhe 1 njësi për shpenzime të përbashkëta(58 njësi; Pmnj=290 kW); Lamela B- 63 njësi banesore, 2 njësi lokale afariste dhe 1 njësi për shpenzime të përbashkëta(66 njësi; Pmnj=330 kW); Pompë e derivateve (1 njësi; Pmnj=25 kW); Restorant 1(1 njësi; Pmnj=35 kW); Restorant 2(1 njësi; Pmnj=35 kW). Sipas projektit shihet se investitori në kërkesën e tij ka paraqitur kërkesë për 127 njësi me fuqi Pmnj=715 kW. Fuqia e transformatorit Sint=1000 kVA ku fuqi maksimale të njëkohshme prej Pmnj=715 kW (sipas projektit elektrik).

Me datë 29.04.2021 KEDS ka lëshuar PEE me nr.3917 me kushtet teknike si me poshtë: Furnizimi i objektit me energji elektrike të bëhet nga LP 10(20) kV drejtimi "Kamenica" me kod 31000029 pre NS 110/10 kV "Prizreni 3". Kycja e TS-it të ri të bëhet në linjën e 10(20)kV skaj rrugës në shtyllën e parë të betonit(e cila duhet të jetë SHB 12/1600) para TS"TS Adil Cabrati" me kod 31000029020 duke e shtrirë kabllon nëntokësorë 10(20) kV TIP XHE 49 3X1X150mm² përmes kanalit kabllorik me gypa dhe puseta sipas projektit elektrik të aprovuar paraprakisht nga Departamenti i investimeve në KEDS deri në kthinën hyrëse të TS të ri. Ndërsa nga kthina dalëse e TS-it të ri të realizohet linja 10(20)kV e re nëntokësore tip XHE 49 3X1X150 mm² përmes kanalit kabllorik me gypa dhe puseta sipas projektit elektrik të aprovuar paraprakisht nga Departamenti i investimeve në KEDS deri në TS me kod 31000029023 "TS NTP T.K". Linja ekzistuese 10 kV ndërmjet pikës A dhe B duhet të eliminohet... .

Pas lëshimit të PEE me nr. 3917 Investitori **T.K "TEA" N.T.SH**, ka parashtruar kërkesë në KEDS që ti bëhet revidimi i Pëlqimit Elektroenergjetik Nr.3917 datë 29.04.2021. Me datë 14.12.2021 KEDS ka lëshuar PEE nr. 12641 të reviduar ku ka theksuar se: Investitori fillimisht është pajisur me PEE nr.3917 datë 29.04.2021 për ndërtimin e trafo stacionit të tij privat Sn=1000 kVA. Në pamundësi të realizimit të punimeve sipas PEE paraprake investitori kërkon revidim të PEE. Pas shqyrtimit të kërkesës së investitorit, KEDS lëshon këtë Pëlqim elektroenergjetik të ri me kushtet teknike të caktuara me poshtë. Po ashtu në PEE është evidentuar vërejtja se: ***Pompa e derivateve, Restoranti 1 dhe Restoranti 2 nuk përfshihen në këtë PEE përderisa nuk kemi Pëlqim parimor nga ana e KOSTT për ndërtimin e objekteve në linjën ekzistuese 110 kV.*** Bazuar në të dhënat e Pëlqimit vërtetohet se zgjidhja teknike i është lëshuar për veprimtarin afariste dhe Banesore :

Lamela A- 55 njësi banesore, 2 lokale dhe 1 njësi për shpenzime të përbashkëta(58 njësi; Pmnj=290 kW); Lamela B- 63 njësi banesore, 2 njësi lokale afariste dhe 1 njësi për shpenzime të përbashkëta(66 njësi; Pmnj=330 kW); Pompë e derivateve (1 njësi; Pmnj=25 kW) nuk përfshihet në këtë PEE; Restorant 1(1 njësi; Pmnj=35 kW) nuk përfshihet në këtë PEE; Restorant 2(1 njësi; Pmnj=35 kW) nuk përfshihet në këtë PEE. PEE përfshin në total 126 njësi me fuqi Pmnj=620 kW.

Fuqia e transformatorit Sint=1000 kVA ku fuqi maksimale të njëkohshme prej Pmnj=620 kW(sipas projektit elektrik).

Sipas zgjidhjes teknike të re, konstatohet se janë ndërruar edhe kushtet teknike të furnizimit si me poshtë: Furnizimi i trafo stacionit të ri me energji elektrike të bëhet nga dalja "Ortakolli" me kod 30000003 e cila furnizohet prej NS 110/35/10 kV "Prizreni 1". Kycja e TS-it të ri duhet të bëhet nga kthina dalëse ekzistuese e trafo stacionit Sn=630 kVA "Durmish Asllani" me kod 30000003006 i tipit blindë Metalike. Nga kthina dalëse deri në kthinën hyrëse të TS të ri të shtrihet kabllorik e re nëntokësorë XHE 49 3X1X150mm² përmes kanalit kabllorik me gypa dhe puseta sipas projektit elektrik të aprovuar paraprakisht nga Departamenti i investimeve në KEDS... ZRRE ka analizuar me vëmendje PEE të ri dhe



konstaton se aplikuesit i janë ndërruar kushtet teknike të kyçjes (vendi për kyçje) sipas kërkesës si dhe konstaton se nga kërkesa për PEE janë larguar: Pompa e derivateve (1 njësi; Pmnj=25 kW); Restorant 1 (1 njësi; Pmnj=35 kW); Restorant 2(1 njësi; Pmnj=35 kW) dhe kjo me vërejtën se: ***Pompa e derivateve, Restoranti 1 dhe Restoranti 2 nuk përfshihen ne këtë PEE përderisa nuk kemi Pëlqim parimor nga ana e KOSTT për ndërtimin e objekteve nën linjën ekzistuese 110 kV.***

Investitori T.K "TEA" N.T.SH, i pa kënaqur me PEE e reviduar ka parashtruar kërkesë ne KEDS qe te i behet revidimi i Pëlqimit Elektroenergjetik nr. 12641 datë 14.12.2021. Me datë 23.08.2022 KEDS ka lëshuar PEE nr. 8623 të reviduar ku ka theksuar se: Investitori fillimisht është pajisur me PEE nr.3917 datë 29.04.2021 për ndërtimin e trafo stacionit të tij privat Sn=1000 kVA. Ne pamundësi te realizimit te punimeve sipas PEE paraprake investitori ka kërkuar revidim për ndryshimin e kushteve teknike dhe është pajisur me Pëlqim Elektroenergjetik Nr. 12641 datë 14.12.2021. Përsëri ne pamundësi te realizimit te punimeve sipas PEE paraprake investitori ka kërkuar revidim të Pëlqimit Elektroenergjetik Nr. 12641 datë 14.12.2021. Pas shqyrtimit te kërkesës se investitorit, KEDS lëshon këtë Pëlqim Elektroenergjetik te ri me kushtet teknike te caktuara me poshtë.

Po ashtu në PEE është evidentuar vërejtja se: ***Pompa e derivateve, Restoranti1 dhe Restoranti 2 nuk përfshihen ne këtë PEE përderisa nuk kemi Pëlqim parimor nga ana e KOSTT per ndërtimin e objekteve nen linjën ekzistuese 110 kV.***

Bazuar në të dhënat e Pëlqimit vërtetohet se zgjidhja teknike i është lëshuar për veprimtarin afariste dhe Banesore :

Lamela A- 55 njësi banesore, 2 lokale dhe 1 njësi per shpenzime te përbashkëta(58 njësi; Pmnj=290 kW); Lamela B- 63 njësi banesore, 2 njësi lokale afariste dhe 1 njësi per shpenzime te përbashkëta(66 njësi; Pmnj=330 kW); Lagje me shtëpi banimi(38 njësi; Pmnj=190 kW); Pompë e derivateve (1 njësi; Pmnj=25 kW) nuk përfshihet ne këtë PEE; Restorant 1(1 njësi; Pmnj=35 kW) nuk përfshihet ne këtë PEE; Restorant 2(1 njësi; Pmnj=35 kW) nuk përfshihet ne këtë PEE.

PEE përfshin ne total 162 njësi me fuqi Pmnj=810 kW.

Fuqia e transformatorit Sint=1000 kVA ku fuqi maksimale te njëkohshme prej Pmnj=810 kW(sipas projektit elektrik)

Sipas zgjidhjes teknike te re konstatohet se janë ndërruar edhe kushtet teknike te furnizimit si me poshtë: Furnizimi i trafo stacionit te ri me energji elektrike te behet nga dalja "Kamenica" me kod 31000029 e cila furnizohet prej NS 110/10 kV "Prizreni 3". Kyçja e TS-it te ri duhet te realizohet nga shtylla ekzistuese e drurit e cila paraprakisht duhet të zëvendësohet me shtyllë te re SHB 12/1600. Nga shtylla kyçëse e deri ne kthinën hyrëse të TS te ri të shtrihet kablllo e re nëntokësorë XHE 49 3X1X150mm2 përmes kanalit kablllovik me gypa dhe pus eta sipas projektit elektrik te aprovuar paraprakisht nga Departamenti i investimeve ne KEDS... ZRRE ka analizuar me vëmendje PEE te ri dhe konstaton se aplikuesit i janë ndërruar kushtet teknike te kyçje s sipas kërkesës si dhe konstaton se nga kërkesa për PEE janë larguar: Pompa e derivateve (1 njësi; Pmnj=25 kW); Restorant 1(1 njësi; Pmnj=35 kW); Restorant 2(1 njësi; Pmnj=35 kW) dhe kjo me vërejtën se: ***Pompa e derivateve, Restoranti1 dhe Restoranti 2 nuk përfshihen ne këtë PEE përderisa nuk kemi Pëlqim parimor nga ana e KOSTT per ndërtimin e objekteve nen linjën ekzistuese 110 kV. Provë: Pëlqimi Elektroenergjetik i reviduar nr. 8623 datë 23.08.2022.***



Investitori **T.K "TEA" N.T.SH**, ka parashtruar kërkesë ne KEDS qe te i behet revidimi i Pëlqimit Elektroenergjetik nr. 8623 datë 23.08.2022. Me datë 04.10.2022 KEDS ka lëshuar PEE nr.10143 të reviduar ku ka theksuar se: Investitori fillimisht është pajisur me PEE nr.3917 datë 29.04.2021 për ndërtimin e trafo stacionit të tij privat Sn=1000 kVA. Investitori nuk e ka marrë Pëlqimin Elektroenergjetik dhe ka kërkuar revidim për ndryshimin e kushteve teknike, ku edhe i është përgatitur Pëlqimi Elektroenergjetik Nr. 12641 datë 14.12.2021 dhe me pas edhe Pëlqimi Elektroenergjetik Nr. 8623 datë 23.08.2022. Investitori nuk e ka marrë Pëlqimin Elektroenergjetik dhe ka kërkuar revidim të Pëlqimi Elektroenergjetik Nr. 8623 datë 23.08.2022. Pas shqyrtimit te kërkesës se investitorit, KEDS lëshon këtë Pëlqim Elektroenergjetik te ri me kushtet teknike te cekura me poshtë.

Po ashtu ne PEE është evidentuar vërejtja se: ***Pompa e derivateve, Restoranti1 dhe Restoranti 2 nuk përfshihen ne këtë PEE përderisa nuk kemi Pëlqim parimor nga ana e KOSTT per ndërtimin e objekteve nen linjën ekzistuese 110 kV.***

Bazuar në të dhënat e Pëlqimit vërtetohet se zgjidhja teknike i është lëshuar per veprimtarin afariste dhe Banesore :

Lamela A- 55 njësi banesore, 2 lokale dhe 1 njësi per shpenzime te përbashkëta(58 njësi; Pmnj=290 kW); Lamela B- 63 njësi banesore, 2 njësi lokale afariste dhe 1 njësi per shpenzime te përbashkëta(66 njësi; Pmnj=330 kW);

Lagje me shtëpi banimi(38 njësi; Pmnj=190 kW);Pompë e derivateve (1 njësi; Pmnj=25 kW) nuk përfshihet ne këtë PEE; Restorant 1 (1 njësi; Pmnj=35 kW) nuk përfshihet ne këtë PEE; Restorant 2(1 njësi; Pmnj=35 kW) nuk përfshihet ne këtë PEE.

PEE përfshin ne total 162 njësi me fuqi Pmnj=810 kW.

Fuqia e transformatorit Sint=1000 kVA ku fuqi maksimale te njëkohshme prej Pmnj=810 kW(sipas projektit elektrik)

Sipas zgjidhjes teknike te re konstatohet se janë ndërruar edhe kushtet teknike te furnizimit si me poshtë: Furnizimi i trafo stacionit te ri me energji elektrike te behet nga dalja "Kamenica" me kod 31000029 e cila furnizohet prej NS 110/10 kV "Prizreni 3". Kycja e TS-it te ri duhet te realizohet nga shtylla ekzistuese e drurit e cila paraprakisht duhet të zëvendësohet me shtyllë te re SHB 12/1600. Nga shtylla kyçese të realizohet linja e re 10(20) kV ajrore përçues te tipit ALFe 3x50 mm² e re deri te shtylla tjetër skaj rrugës kryesore e cila duhet te jetë SHB 12/1600, ndërsa pjesa e tjetër e linjës 10(20) kV deri ne kthinën hyrëse të TS te ri të shtrihet kablllo e re nëntokësorë XHE 49 3X1X150mm² përmes kanalit kablllovik me gypa dhe pusët sipas projektit elektrik te aprovuar paraprakisht nga Departamenti i investimeve ne KEDS.... ZRRE ka analizuar me vëmendje PEE te ri dhe konstaton se aplikuesit i janë ndërruar kushtet teknike te kyçe s sipas kërkesës si dhe konstaton se nga kërkesa për PEE janë larguar: Pompa e derivateve (1 njësi; Pmnj=25 kW); Restorant 1(1 njësi; Pmnj=35 kW); Restorant 2(1 njësi; Pmnj=35 kW) dhe kjo me vërejtjen se: ***Pompa e derivateve, Restoranti1 dhe Restoranti 2 nuk përfshihen ne këtë PEE përderisa nuk kemi Pëlqim parimor nga ana e KOSTT për ndërtimin e objekteve nen linjën ekzistuese 110 kV. Bazuar ne dokumentacionin e ofruar nga investitori si dhe nga KEDS vërtetohet se investitori ka pranuar si dhe ka bërë pagesën e Pëlqimit elektroenergjetik nr. 10143 të datës 04.10.2023 ne vlerë 14,549.40 €.***

ZRRE ka shqyrtuar dokumentacionin e dorëzuar nga dy palët dhe vëren se: Investitori **T.K "TEA" N.T.SH** ne përputhje me nenin 8 të Rregullës per Kushtet e Përgjithshme te furnizimit me Energji ka aplikuar për Pëlqim elektroenergjetik për objektin afarist-Banesor Lamela A- 55 njësi banesore, 2 lokale dhe 1 njësi per shpenzime te përbashkëta(58 njësi; Pmnj=290 kW); Lamela B- 63 njësi banesore, 2 njësi lokale



afariste dhe 1 njësi për shpenzime të përbashkëta (66 njësi; Pmnj=330 kW); Pompë e derivateve (1 njësi; Pmnj=25 kW); Restorant 1 (1 njësi; Pmnj=35 kW); Restorant 2 (1 njësi; Pmnj=35 kW). Sipas projektit shihet se investitori në kërkesën e tij ka paraqitur kërkesë për 127 njësi me fuqi Pmnj=715 kW. Pas kërkesës së investitorit, KEDS me datë 29.04.2021, ka lëshuar Pëlqim Elektroenergjetik me Nr.3917 për Lamela A - 55 njësi banesore, 2 lokale dhe 1 njësi për shpenzime të përbashkëta (58 njësi; Pmnj=290 kW); Lamela B - 63 njësi banesore, 2 njësi lokale afariste dhe 1 njësi për shpenzime të përbashkëta (66 njësi; Pmnj=330 kW); Pompë e derivateve (1 njësi; Pmnj=25 kW); Restorant 1 (1 njësi; Pmnj=35 kW); Restorant 2 (1 njësi; Pmnj=35 kW) me kërkesën për ndërtimin e TS të ri me fuqi të instaluar Sint=1000 kVA ku fuqi maksimale të njëkohshme prej Pmnj=715 kW (sipas projektit elektrik) e që kjo është në përputhje me nenin 9 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të furnizimit me Energji e ku thuhet se: *Pas regjistrimit të aplikacionit për kyçje/modifikim të kyçjes ekzistuese, Operatori i Sistemit duhet të bëjë veprimet e nevojshme që të studioj kërkesat teknike të kyçjes, nëse është e nevojshme të vizitojë pronat që janë subjekt i aplikimit, dhe të hartojë dhe dërgoj ofertën për kyçje në formë të shkruar, në pajtim me metodologjinë e taksave për kyçje.* Po ashtu në paragrafin 2.2 të këtij neni thuhet se: *Oferta për kyçje në rrjetin elektrik duhet të përmbajë të dhënat për punët e nevojshme për të kyçur një shfrytëzues të sistemit në rrjetet ekzistuese të transmetimit ose shpërndarjes si dhe marrjen e pëlqimit të nevojshëm për këtë qëllim në rastin kur kërkohet zgjerim ose përforcim në rrjetin e transmetimit ose shpërndarjes, për të rregulluar kërkesën e supozuar ose kriteret për kapacitet të aplikuesit; të definuar si “kyçje e thellë”, për aplikuesit, siç është përcaktuar në Metodologjitë e Tarifave dhe në Metodologjinë e Taksave për Kyçje.* Po ashtu në nenin 9 paragrafin 1 të Metodologjisë së taksave për kyçje të rrjetit të Shpërndarjes thuhet se: *Çdo person fizik apo juridik, gjenerator/prodhues apo Konsumator Prodhues mund të aplikojë për kyçje të re apo modifikim të kyçjes ekzistuese në Sistemin e Shpërndarjes, me qëllim të furnizimit me energji elektrike apo gjenerimit të energjisë elektrike”* kurse në paragrafin 3 nën paragrafin 3.1 dhe 3.3 thuhet se: 3.1 *“Përdoruesit ekzistues ose të ardhshëm të sistemit të shpërndarjes duhet të marrin ofertën e kyçjes për kyçje në sistemin e shpërndarjes nga OSSH kur: ndërtojnë objekte të reja që duhet të lidhen me sistemin e shpërndarjes dhe 3.3”kërkojnë një ndryshim ose rindërtim të kyçjes së tyre në sistemin e shpërndarjes”.* Në nenin 10 paragrafin 10.2 të Metodologjisë së taksave për kyçje të rrjetit të Shpërndarjes thuhet se: *Kushtet Teknike sipas të cilave do të ofrohet dhe/apo kryhet kyçja, materialet, pajisjet dhe punët e përfshira, e të gjitha këto konform standardeve relevante të përcaktuara në kodet teknike. Në Ofertën për Kyçje duhet të jenë të përfshira edhe kushtet teknike dhe se pika e kyçjes do t’i jepet Aplikuesit nga pika më e afërt e përshtatshme e rrjetit të OSSH. Në rastet kur aplikuesi mund të marrë leje (autorizim noterial) nga pronarët e aseteve private dhe ka mundësi kyçje në atë pikë atëherë kyçja mund t’i ipet nga ato asete. Me rastin e marrjes së lejes nga pronari i asetit privat nënkuptohet se palët (aplikuesi dhe pronari i asetit) kanë arritur marrëveshje për kompensim të ndërsjellët si dhe pronari i asetit është në dijeni të plotë se pjesa e asetit të përbashkët do të duhet të transferohet në pronësi të OSSH-së. Kompensimi i pjesës së transferuar behet sipas kësaj metodologjie. OSSH do të ketë drejtën e plotë të aseteve të transferuara duke përfshirë edhe kyçjen e konsumatorëve potencial në të ardhmen.* Po ashtu konstatohet se përveç PEE nr. 3917 të datës 29.04.2021 për shkak se një pjesë e objekteve për të cilat investitori ka kërkuar nga KEDS, PEE për kyçje ndodhen në nivelin e tensionit 110 kV i cili është në pronësi dhe menaxhim të KOSTT (Operatori i Sistemit Transmisionit dhe Tregut) dhe për shkak të zonave të sigurisë së ndërtimit, KEDS me kërkesë të investitorit ka lëshuar edhe tri Pëlqime Elektroenergjetike të reviduara (nr. 12641 datë 14.12.2021, nr. 8623 datë 23.08.2022 nr. 10143 datë 04.10.2022) duke përjashtuar 3 njësi pra: pompën e derivateve (1 njësi; Pmnj=25 kW); Restorant 1 (1



njësi; Pmnj=35 kW); Restorant 2 (1 njësi; Pmnj=35 kW) deri ne Pëlqimin parimor te lëshuar nga KOSTT e qe kjo nënkupton edhe kryerjen e punimeve te investitorit sipas kushteve teknike qe do te nxjerr KOSTT. Bazuar në dokumentacionin e ofruar nga investitori, si dhe nga KEDS vërtetohet se investitori ka pranuar vetëm Pëlqimin elektroenergjetik nr. 10143 të datës 04.10.2023, si dhe ka bërë pagesën e në vlerë 14,549.40 €, por të cilin edhe pasi e ka paguar e ka kundërshtuar dhe ka parashtruar kërkesë në KEDS që të i bëhet revidimi i Pëlqimit Elektroenergjetik nr. 10143 datë 04.10.2022 duke kërkuar që t'i bëhen ndryshimet e kushteve teknike te kyçjes të dhëna përmes Pëlqimit Elektroenergjetik nr. 10143 datë 04.10.2022. Me datë 06.10.2022 KEDS përmes një përgjigje e refuzon kërkesën e palës për ndryshim të kushteve teknike të dhëna me PEE nr.10143 dt. 04.10.2022, konkretisht mënyrën e kyçje së trafo stacionit tuaj është refuzuar dhe mbesin ne fuqi kushtet teknike te dhëna ne Pëlqimin Elektroenergjetik nr. 10143 datë 04.10.2022. Ne arsyetimin e përgjigjes është theksuar se ju mund te vazhdoni me procedurën e realizimit te Pëlqimit Elektroenergjetik nr. 10143 datë 04.10.2022 për kyçjen e tarfostacionit të ri sipas zgjidhjes teknike te dhen me PEE, sepse realizimi i linjës 10(20) kV ne prona private nuk është i lejueshëm nga ana e KEDS-it. Po ashtu pas kërkesës se përsëritur te aplikuesit, për revidim të kushteve teknike të dhëna me PEE nr.10143 dt. 04.10.2022 duke ofruar edhe dokumente shtesë pronësore, me datë 17.11.2022 KEDS përmes një përgjigje e refuzon kërkesën e palës revidimin e PEE nr.10143 dt. 04.10.2022, dhe mbeten ne fuqi kushtet teknike të dhëna me PEE nr.10143 dt. 04.10.2022. Në arsyetimin e dhënë theksohet se: Propozimi i juaj nuk mund të realizohet për shkak se rruga ku ju keni kërkuar të ndërtoni linjën e re 10(20) kV nuk është rrugë publike. Linje a re 10(20) kV duhet te realizohet skaj rrugës publike. Për furnizim me energji elektrike të objekteve tuaja duhet bërë ndryshimet e cekura në PEE paraprak. Prandaj ju mund të vazhdoni me procedurën e realizimit të Pëlqimit Elektroenergjetik nr. 10143 datë 04.10.2022 sepse KEDS nuk e sheh të arsyeshme ndryshimin e kushteve teknike. Bazuar ne nenin 10.2.5 të Metodologjisë se taksave per kyçje te rrjetit te Shpërndarjes e qe ka te beje me ofertat për kyçje thuhet se: Oferta për Kyçje e OSSH do të përmbajë:

- *“Kushtet Teknike sipas të cilave do të ofrohet dhe/apo kryhet kyçja, materialet, pajisjet dhe punët e përfshira, e të gjitha këto konform standardeve relevante të përcaktuara në kodet teknike. Në Ofertën për Kyçje duhet të jenë të përfshira edhe kushtet teknike dhe se pika e kyçjes do t'i jepet Aplikuesit nga pika më e afërt e përshtatshme e rrjetit të OSSH. Në rastet kur aplikuesi mund të merr leje (autorizim noterial) nga pronarët e asetëve private dhe ka mundësi kyçje në atë pikë atëherë kyçja mund t'i ipet nga ato asetë. Me rastin e marrjes së lejes nga pronari i asetit privat nënkuptohet se palët (aplikuesi dhe pronari i asetit) kanë arritur marrëveshje për kompensim të ndërsjellët si dhe pronari i asetit është në dijeni të plotë se pjesa e asetit të përbashkët do të duhet të transferohet në pronësi të OSSH-së. Kompensimi i pjesës se transferuar behet sipas kësaj metodologjie. OSSH do të ketë drejtën e plotë të asetëve të transferuara duke përfshirë edhe kyçjen e konsumatorëve potencial në të ardhmen”.* Në kapitullin e IV te Kodit te OSSH janë definuar Kushtet Teknike të Kyçjes në Sistemin e Shpërndarjes qëllimi i së cilit është përmbushja e objektivave si ne vazhdim: Gjithë Shfrytëzuesit ekzistues të Sistemit të Shpërndarjes ose ata potencialë të trajtohen në mënyrë të barabartë, çdo kyçje e re nuk duhet të shkaktojë ndonjë efekt negativ tek Shfrytëzuesit ekzistues, ose një kyçje e re nuk duhet të ndikohet nga efektet negative të Shfrytëzuesve ekzistues, të ndihmojë Shfrytëzuesit e Sistemit të Shpërndarjes që të zbatojnë detyrimet e tyre dhe të sigurojnë operim dhe mirëmbajtje me cilësi të lartë të instalimeve të tyre dhe të specifikojë qartë dhe në një format standard, detyrimet dhe përgjegjësitë për të gjithë Shfrytëzuesit e Sistemit të Shpërndarjes, për çdo vend ku punohet/modifikohet një kyçje. Ne paragrafin 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3. 4.2.1, 4.2.2 dhe 4.2.2 thuhet se: 4.1.1 *Është e domosdoshme të kërkohet përmbushja*



e kriterit minimal të caktuar teknik, të dizajnit dhe atij operativ nga stabilimenti dhe aparatura e Shfrytëzuesit në mënyrë që të mirëmbahet deri në atë masë që është e kërkuar nga Praktika e Mirë Industriale (Standardet IEC ose SKEN) për operim stabil dhe të sigurtë të Sistemit të Shpërndarjes, për të mirën e të gjithë Shfrytëzuesve dhe për mbrojtjen e Sistemit të Shpërndarjes, stabilimenteve të Shfrytëzuesit dhe aparateve drejtpërdrejt të lidhur në Sistemin e Shpërndarjes, 4.1.2. Kushtet e Kyçjes në Sistemin e Shpërndarjes themelojnë parime dhe standarde të caktuara që kanë të bëjnë me dispozitat për kyçje, metodën e kyçjes, standardet teknike dhe standardet e performancës. Kushtet e Kyçjes në Sistemin e Shpërndarjes, specifikojnë informatën që duhet të sigurohet nga Shfrytëzuesi për të siguruar që dispozitat adekuate mund të zbatohen nga OSSh për kyçjet e reja apo rritjen e ngarkesës ekzistuese. Gjithashtu kjo aplikohet tek Prodhuesit të cilët operojnë paralel me Sistemin e Shpërndarjes, kur kyçja është e kërkuar. Shfrytëzuesit e ardhshëm duhet në kohë të paraqesin tek OSSh-ja të gjitha detajet që janë paraqitur në këtë kapitull 4.1.3. Në lidhje me Kushtet e Kyçjes, duhet të nënshkruhet Marrëveshja për Kyçje, e cila është marrëveshje bilaterale në mes OSSh dhe secilit Shfrytëzues, e cila përmban detaje specifike për secilën kyçje të Shfrytëzuesve dhe për përdorimin e Sistemit të Shpërndarjes. Marrëveshja për Kyçje kërkon që Shfrytëzuesi dhe OSSh-ja të veprojnë në përputhje me kushtet e Kodit të Shpërndarjes. Në përgjithësi fillimisht lëshohet dokumenti bazik për kyçje, në të cilin definohen saktë kushtet teknike të kyçjes, të cilat Shfrytëzuesi është i obliguar t'i përmbush para kyçjes në rrjetin e shpërndarjes, 4.2.1. Kushtet e Kyçjes definojnë standardet minimale për mënyrën e kyçjes në Sistemin e Shpërndarjes, standardet teknike të dizajnit dhe ato të operimeve, me të cilat Shfrytëzuesi i cili kyçet në Sistemin e Shpërndarjes duhet të pajtohet, 4.2.2. Kushtet e Kyçjes specifikojnë aranzhimet teknike të kërkuara në Kufirin e Pronësisë në mes të Sistemit të Shpërndarjes dhe instalimit të Shfrytëzuesit dhe është e aplikueshme në të gjitha nivelet e tensionit të mbuluara nga Kodi i Shpërndarjes. 4.2.3. Kushtet e Kyçjes përveç tjerash për komunikim, lexim dhe monitorim nënvizojnë edhe llojin e sinjaleve dhe ngjarjeve adekuate që do të kërkohen nga secili Shfrytëzues për t'i lënë në dispozicion të OSSh-së.

Aplikuesi në ankesën e tij drejtuar ZRRE thekson se kundërshton Pëlqimin Elektroenergjetik nr. nr.10143 dt. 04.10.2022 pasi që KEDS nuk ka ofruar piken me te afërt te kyçje s. Përveç kësaj konsumatori ka ngritur shqetësimin e pagesës për kapacitet për objektet për te cilat KEDS ka lëshuar PEE. Aplikuesi në ankesën e tij ka kërkuar po ashtu qe ndërtimi i LP tokësor i cili sipas zgjidhjes teknike i është kërkuar te ndërtohet në rrugën kryesore te behet në mes te shtëpive. Aplikuesi në shkresat e tjera si problem ka paraqitur edhe pamundësinë e kalimit neper pronën nr. P-718813068-04914-0 për te cilën thotë se është pronë shoqërore dhe se KEDS nuk ka marr parasysh mundësin për marrjen e autorizimit nga pronari me qëllim te mundësimit te kalimit te rrjetit ashtu siç parashihet edhe në PEE pika 4 ku thuhet se: Për lëshimin e trafo stacionit te ri në pune investitori është i obliguar qe te posedojë këtë dokumentacion: Lejen e ndërtimit te objektit energjetik nga institucionet përkatëse për pronat shoqërore, ndërkaq lejen e noterizuar nga pronaret e pronave private. ZRRE ka shqyrtuar te gjitha pretendimet e investitorit dhe ka vërtetuar se këto nuk janë te sakta pasi qe konsumatorit i është mundësuar kyçja në piken me te afërt te mundshme në rrjetin e Distribucionit si dhe aplikuesi nuk ka ofruar leje te noterizuar nga pronaret e pronave publike si dhe ato private. Po ashtu sa i përket ngarkesës për kapacitetin e kërkuar me PEE i njëjti është kalkuluar drejt nga KEDS bazuar edhe në ngarkesat e kërkuar nga aplikuesi për kyçjen e objekteve te parapara me projekt.

Bordi i ZRRE duke pasur parasysh të gjitha faktet e përmendura më lartë, dëshmitë dhe argumenteve të paraqitura nga palët e në veçanti Pëlqimet Elektroenergjetike nr. 3917 te datës 29.04.2021 nr. 12641



datë 14.12.2021, nr. 8623 datë 23.08.2022 dhe nr. 10143 datë 04.10.2022, respektimit të Rregullës Për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, Metodologjisë së taksave për kyçe të rrjetit të Shpërndarjes, Kodit të Rrjetit të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe procedurave në fuqi, pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimin të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Lutfije Dervishi, anëtare

Gani Buçaj, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Aplikuesi: **T.K "TEA" N.T.SH**
- KESCO-së dhe
- Arkivit të ZRRE-së.